



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*

---

**Strategjia për përmirësimin e planifikimit dhe  
koordinimit të politikave në Kosovë  
(Sistemi i Planifikimit të Integruar)  
2016-2018**

**Prishtinë, maj 2015**

## Përmbajtja

A.	Përmbledhje ekzekutive.....	4
B.	Rëndësia e reformës.....	6
C.	Komponentët e Sistemit për Planifikim të Integruar .....	9
1.	Përmirësimi i Kornizës Strategjike të Planifikimit.....	9
1.1	Strategjia Kombëtare për Zhvillim.....	9
1.2	Konsolidimi i kornizës së strategjive sektoriale .....	10
2.	Përmirësimi i procesit të vendimmarrjes .....	12
	<i>(i) Përmirësimi i koordinimit të politikave dhe procesit të vendimmarrjes në nivelin qendror të Qeverisë .....</i>	<i>12</i>
	<i>(ii)Përmirësimi i koordinimit të politikave dhe vendimmarrjes në nivelin e ministrive ..</i>	<i>13</i>
3.	Integrimi i Procesit – Kalendari i Planifikimit të Integruar .....	15
4.	Planifikimi i Integrimit Evropian.....	16
5.	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve/Buxheti Vjetor .....	17
6.	Programimi i Investimeve Publike .....	19
7.	Menaxhimi i ndihmës së jashtme.....	21
8.	Monitorimi i integruar – llogaridhënia dhe zbatimi .....	24
	Aneksi – Kalendari i Zbatimit të SPI-së.....	27

## *Lista e shkurtesave*

<b>BDMS</b>	Sistemi për Menaxhimin dhe Zhvillimin e Buxhetit
<b>EA</b>	Asistenca e Jashtme
<b>IE</b>	Integrimi Evropian
<b>KBF</b>	Komisioni Qeveritar për çështje Buxhetore dhe Fiskale
<b>SKQ</b>	Sekretariati Koordinues i Qeverisë
<b>PQ</b>	Programi i Qeverisë
<b>KMPQ</b>	Komisioni për Modernizimin e Planifikimit të Qeverisë
<b>PVPQ</b>	Plani Vjetor i Punës së Qeverisë
<b>SPI</b>	Sistemi i Planifikimit të Integruar
<b>ZL</b>	Zyra Ligjore
<b>MIE</b>	Ministria e Integrimit Evropian
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>KASH</b>	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
<b>SKZH</b>	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
<b>NPAA</b>	Plani Kombëtar për Miratimin e Acquis
<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit
<b>IP</b>	Investime Publike
<b>KIP</b>	Komisioni për Investime Publike
<b>PIP</b>	Programi për Investime Publike
<b>PMSA</b>	Plani për Zbatimin e MSA-së
<b>GMS</b>	Grupi për Menaxhim Strategjik
<b>KPS</b>	Komisioni për Planifikim Strategjik
<b>ZPS</b>	Zyra për Planifikim Strategjik
<b>GDPS</b>	Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik
<b>SS</b>	Strategji Sektoriale

## A. Përmbledhje ekzekutive

---

Ky dokument paraqet orientimin strategjik të Qeverisë së Republikës së Kosovës si pjesë e shtyllës së dytë të Reformës së Administratës Publike. Dokumenti trajton planifikimin dhe koordinimin e politikave në nivelin qendror të qeverisë, por edhe në nivelin e ministrive të linjës. Si parim strategjia përmes veprimeve konkrete duke filluar nga viti 2015 synon vendosjen e një sistemi të planifikimit të integruar, për tu zbatuar gjatë periudhës së ardhshme tre vjeçare.

Në përgjithësi institucionet e Kosovës janë të vetëdijshme për faktin se krahas progresit të arritur gjatë dekadës së fundit, gjendja aktuale e proceseve qendrore të planifikimit nuk është në standardet e dëshirueshme. Gjithashtu, duke marr parasysh hapësirën e ngushtuar fiskale dhe situatën ekonomike, si dhe intensifikimin e procesit të integritimit Evropian, vendosja e një planifikimi më efektivë është i domosdoshëm. Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe koordinimit i propozuar me këtë strategji (ndryshe i quajtur si Sistemi për Planifikim të Integruar) fokusohet në një ridizajnim teknik të proceseve qendrore të planifikimit të politikave dhe atij financiar të Qeverisë. Supozimi themelor i këtyre ndryshimeve është se cilësia dhe koherenca e këtyre proceseve teknike ndikon shumë në arritjen e synimeve të Qeverisë dhe mbajtjen e premtimeve të bërë për publikun e Kosovës.

**Qëllimi kryesor i përmirësimit të sistemit të planifikimit në Kosovë është evitimi i fragmentimeve dhe dyfishimeve ndërmjet proceseve qendrore të planifikimit të politikave dhe atij financiar.** Fokusi kryesor i përmirësimit do të jetë në dy korniza qendrore që duhet të mbuloj të gjitha proceset planifikuese të qeverisë:

- **Korniza e Planifikimit Strategjik:** Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH); dhe strategjitë sektoriale përcaktojnë kornizën strategjike të qeverisë, duke përfshirë synimet afatmesme dhe afatgjate dhe strategjitë për të gjithë sektorët; dhe
- **Korniza e planifikimit buxhetor:** Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), që kërkon që secila ministri të zhvilloj plane tre vjeçare për arritjen e objektivave dhe synimeve brenda kufijve të shpenzimeve.

Krahas kësaj, ekzistojnë pesë procese kryesore (komponentë të SPI-së) që ndikojnë në një gamë të gjerë të aktiviteteve planifikuese të qeverisë dhe duhet të jenë plotësisht të reflektuara në kornizën e planifikimit strategjik dhe KASH. Dokumenti është i bazuar në këto komponentë/objektiva për përmirësimin e planifikimit dhe koordinimit të politikave në Kosovë:

- (i) **Korniza e Planifikimit Strategjik**
- (ii) **Procesi i vendimmarrjes në nivelin e lartë**
- (iii) **Kalendari i Integruar (integrimi i procesit)**
- (iv) **Planifikimi i KASH/buxhetit vjetor**
- (v) **Integrimi Evropian**
- (vi) **Investimet Publike<sup>1</sup>**
- (vii) **Ndihma e Jashtme**
- (viii) **Monitorimi i Integruar**

---

<sup>1</sup> Kjo referohet në Programin për Investime Publike (PIP). Teknikisht, programi për investime publike është komponentë e shpenzimeve publike dhe menaxhohet në kuadër të procesit të KASH-it dhe buxhetit vjetor. Në këtë dokument adresohet në mënyrë të veçantë ngase kërkon një proces ndryshe të identifikimit dhe vlerësimit që kërkon përmirësime të dukshme për tu ndërlidhur në mënyrë të mirëfilltë me vendimmarrjen në kuadër të procesit të planifikimit të KASH-it dhe buxhetit vjetor.

Baza për një arkitekturë të përmirësuar të planifikimit tashmë ekziston në Kosovë. Prandaj, *sfida nuk qëndron tek krijimi i një sistemi krejtësisht të ri, por riformësimin, harmonizimin dhe lidhjeve e proceseve ekzistuese.*

Në përgjithësi, kjo strategjia (bazuar në të ashtuquajturin Sistemi i Planifikimit të Integruar në Kosovë) nuk propozon as një sistem të ri por as sistem të veçantë të planifikimit. Strategjia nuk është as përpjekje për të bashkuar proceset ekzistuese në një proces të veçantë. Ajo që ofron kjo strategji është një numër i parimeve funksionale dhe strukturave mbështetëse për të siguruar se **planifikimi dhe monitorimi qeveritar si tërësi ndërmerren në mënyrë efektive, të integruar dhe harmonizuar.**

Duke marr parasysh fazën e hershme të reformave institucionale në Kosovë, është koha e duhur për të adresuar çështje lidhur me përmirësimin e planifikimit dhe koordinimit të politikave. Institucionet e Kosovës janë të vetëdijshme se nëse nuk ndërmerret ndonjë veprim tani këto probleme për disa vite mund të bëhen të pa-menaxhueshme me përshpejtimin e reformave ambicioze të Kosovës. Përkrahja politike konsiderohet si faktor vendimtar i suksesit për modernizimin e sistemit të planifikimit të Qeverisë së Kosovës.

Zbatimi i SPI-së do të bëhet në tri faza përgjatë periudhës 2015-2018.

- **2015:** Fokusi do të jetë në arkitekturën e procesit, ngritje të kapaciteteve të institucioneve qendrore (ZKM, MF, MIE). Në kuadër të ministrive të linjës, gjatë vitit të parë do të vihet theksi në krijimin e strukturave mbikëqyrëse, zgjerimin e vetëdijesimit ministror për SPI.
- **2016-2017:** Do të ketë fokus zbatimin e plotë të proceseve të SPI-së në të gjitha ministrinë e linjës, me theks në fuqizimin e koordinimit dhe strukturave vendimmarrëse si dhe ngritjen e kapaciteteve planifikuese të ministrive.
- **2018 dhe më tutje:** do të fokusohet në cilësinë e zbatimit, me theks të veçantë në fuqizimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe ngritjen e kapaciteteve të ministrive për ofrim të shërbimeve.

Dokumenti është i organizuar në tri pjesë: kapitulli i parë paraqet kontekstin për përmirësimin e arkitekturës planifikuese në Kosovë përmes vendosjes së Sistemit për Planifikim të Integruar; kapitulli i dytë paraqet implikimet e propozuara për secilën komponentë të arkitekturës planifikuese; kapitulli i tretë paraqet një përmbledhje të kalendarit të veprimeve për zbatimin e SPI-së në Kosovë përgjatë periudhës 2015-2018.

Përfundimisht, Qeveria e Kosovës është e vetëdijshme për faktin se vendosja e një sistemit të integruar të planifikimit dhe monitorimit nuk mund të arrihet thjeshtë me zgjidhje “të përkohshme”. Zbatimi dhe funksionalizimi i sistemit do të merr kohë dhe përveç përmirësimeve strukturore, përfshinë ndryshime të kulturës së menaxhimit dhe administrimit. Ky proces do të ketë përkrahjen e plotë të nivelit më të lartë të Qeverisë, Kryeministrit dhe Kabinetit të tij. Në këtë aspekt, institucionet e Kosovës mund të nxjerrin mësim të shumta nga përvoja e vendeve të tjera që kanë kaluar përmes procesit të njëjtë kohë më parë. Shumë nga vendet e BE-së të anëtarësuara kohëve të fundit janë ballafaquar me probleme të ngjashme në fazat e hershme të rrugës së tyre të anëtarësimit. Disa vende që kanë vendosur një sistem të integruar sikurse Shqipëria, Lituania dhe Sllovenia paraqesin një model të mirë për Kosovën nëse marrim parasysh se madhësia dhe përvoja e zhvillimit institucional të këtyre vendeve nuk dallojnë shumë nga Kosova.

## B. Rëndësia e reformës

Qeveria e Kosovës konsideron se përmirësimi i koordinimit të planifikimit të politikave mbetet një sfidë për institucionet e Kosovës në rrugëtimin e përgatitjes së vendit drejt integritit Evropian. Ekziston nevoja për harmonizim më të mirë ndërmjet politikave, në veçanti politika prioritare të reja, dhe buxhetit. Natyrisht se kornizat e veçanta të planifikimit dhe buxhetimit janë përgjegjësi e organizatave të ndryshme të qeverisë, megjithatë paraqitet nevoja që të përmirësohen mekanizmat ekzistues që sigurojnë një koordinim dhe integrim të mirë të të gjitha proceseve. Për të adresuar këtë, është iniciuar një qasje e përbashkët e Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Integritit Evropian për tu dakorduar se si mund të përmirësohen instrumentet kryesore për harmonizimin e politikave me buxhetin.

Institucionet e Kosovës janë të vetëdijshme për faktin se krahas progresit të arritur gjatë dekadës së fundit, gjendja aktuale e proceseve qendrore të planifikimit nuk është në standardet e dëshirueshme. Gjithashtu, duke marr parasysh hapësirën e ngushtuar fiskale dhe situatën ekonomike, si dhe intensifikimin e procesit të integritit Evropian, vendosja e një planifikimi më efektivë është i domosdoshëm.

Veprimet e propozuara me këtë Strategji fokusohen në një ridizajnim teknik të proceseve qendrore të planifikimit të politikave dhe atij financiar të Qeverisë. Supozimi themelor i këtyre ndryshimeve është se cilësia dhe koherenca e këtyre proceseve teknike ndikon shumë në arritjen e synimeve të Qeverisë dhe mbajtjen e premtimeve të bërë për publikun e Kosovës. Për këtë kjo strategji përcakton hapat për institucionet qendrore të qeverisë për të integruar sistemet e fragmentuara të planifikimit të politikave dhe planifikimit financiar dhe program të veçantë për ngritje të kapaciteteve.

**Qëllimi kryesor i përmirësimit të sistemit të planifikimit në Kosovë është evitimi i fragmentimeve dhe dyfishimeve ndërmjet proceseve qendrore të planifikimit të politikave dhe atij financiar.** Tabela e mëposhtme ilustron se si do të ndryshojë sistemi i planifikimit mënyrën e jetësimit të këtyre proceseve dhe mënyrën se si institucionet qendrore ndërveprojnë me ministrinë.

Para SPI	Post-SPI
<ul style="list-style-type: none"><li>Kryeministri dhe Qeveria përfshihen në faza të vonshme të procesit të planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>KM dhe vendimmarrësit tjerë do të jenë më aktivisht të angazhuar që në fillim të procesit të planifikimit.</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>Nuk ka vizion gjithëpërfshirës të zhvillimit kombëtar</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Strategjia Kombëtare për Zhvillim do të krijoj një sistem të shtytur nga politikat që mbështet synimet afatgjata të vendit dhe këshillon qeverinë mbi opsionet e prioriteteve strategjike;</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>Numri i madh i strategjive sektoriale rezultojnë në një inflacion të prioriteteve</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Kornizë e konsoliduar strategjike e strategjive sektoriale dhe ndër-sektoriale e udhëzuar nga SKZH</li></ul>
<ul style="list-style-type: none"><li>Objektivat nga Strategjitë sektoriale dhe dokumentet e procesit të integritit Evropian nuk janë të reflektuara si duhet në KASH</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Një “strukturë bazuar mbi programet” e harmonizuar dhe e prezantuar në KASH/buxhet vjetor dhe njëkohësisht në përputhshmëri me strategjitë sektoriale, duke reflektuar procesin e Integritit Evropian</li></ul>


<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raporte minimale të punës ndërmjet ZKM/MF/MIE</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik do të jetë i rëndësishëm për koordinimin e SPI-së dhe do të përfshijë koordinimin aktiv të njësive të ZKM-së, MF dhe MIE.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Proces i paqartë i vendimmarrjes së ministrive të linjës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në kuadër të secilës Ministri, një grup menaxhues i përhershëm, i drejtuar nga Ministri dhe në përbërje të stafit të lartë menaxhues (udhëheqësit e programeve) do të mbikëqyrin dhe monitorojnë zbatimin e të gjitha proceseve qendrore të planifikimit të politikave dhe atij financiar.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kalendar dhe afatet e planifikimit nuk janë të koordinuara</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një Kalendar i Integruar i Planifikimit do të lëshohet në fillim të secilit vit për të mbuluar kërkesat dhe afatet kryesore për të gjitha proceset e planifikimit të politikave dhe buxhetit si dhe aspektet kryesore të vendimmarrjes ku KM dhe Qeveria duhet përfshirë.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prioritetet e asistencës së jashtme të qeverisë nuk janë të definuara mirë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një dokument i unifikuar listës së projekteve prioritare për asistencës së jashtme do të prodhohet që identifikon të gjitha fushat prioritare ku kërkohet asistencë e jashtme (donatorët)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Secili proces qendror ka krijuar sisteme vetanake të monitorimit dhe raportimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një Plan për Monitorimin e Punës së Qeverisë do të negociohet me secilën ministri duke përmblodhur të gjitha produktet dhe indikatorët kryesor për tu monitoruar në qendër.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Programe të veçanta trajnimit janë dhënë për secilin proces qendror</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Programe të Kombinuara trajnimi do të ofrohen ku është e nevojshme</li> </ul>

**Një Komision për Planifikim Strategjik i udhëhequr nga Kryeministri do të jetë struktura në krye të arkitekturës së SPI-së.** Në thelb, Komisioni për Planifikim Strategjik do të jetë përgjegjës për drejtimin e procesit të planifikimit të politikave para vendimmarrjes përfundimtare nga Qeveria. Këshilli për Reformën e Administratës Publike do të udhëzojë dizajnimin, implikimet ristrukturuese përgjegjëse për zbatimin e sistemit.

**Në nivelin e Ministrive të linjës zbatimi i SPI-së do të jetë përgjegjësi e secilit Ministër.** Drejtuesit e lartë të ministrisë do të krijojnë Grup të Menaxhimit Strategjik për të siguruar cilësinë dhe për të monitoruar zbatimin e sistemit të ri të planifikimit. Grupi do të drejtohet nga Ministri (ose Zëvendës Ministri në emër të tij/saj), i koordinuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe në përbërje të Drejtorëve të Departamenteve kryesore.

**Seksionet në vijim paraqesin përmirësimet e procesit në secilin komponentë të Sistemit për Planifikim të Integruar.**

# KORNIZA E PROPOZUAR E PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR TË KOSOVËS





## C. Komponentët e Sistemit për Planifikim të Integruar

---

### 1. Përmirësimi i Kornizës Strategjike të Planifikimit

Kosova duhet të vendos një kornizë gjithëpërfshirëse të planifikimit strategjik. Në përgjithësi nuk qasje koherente që ndërlidhë synimet afatgjate me një strategji afatmesme përmes të cilës strategjitë horizontale dhe sektoriale informojnë procesin e KASH-it. Gjithashtu, nivelet e planifikimit nuk janë të ndërlidhura si duhet përmes kornizës makroekonomike dhe skenarëve të kostimit. Me më tepër se 80 strategji sektoriale dhe nivele të tjera të dokumenteve planifikuese, ekziston një prirje e lartë e fragmentimit, mospërputhje dhe presion të qartë nga poshtë-lartë që rezulton me plane jo-reale të cilat nuk janë të prioritetuara në mënyrë të mirëfilltë. Nivele dhe lloje të ndryshme të prioriteteve nuk janë të përkufizuara në mënyrë të qartë dhe të qëndrueshme, ndërsa në shumicën e rasteve mungojnë tregues dhe caqe të sakta. Strategjitë sektoriale vështirë se mund të shfrytëzohen si plane strategjike ose të monitorohen në formë të duhur.

Dy veprime kyçe që synojnë përmirësimin e kornizës së planifikimit strategjik do të përfshijnë:

- Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, dhe
- Konsolidimi dhe përmirësimi i kornizës së strategjive sektoriale.

#### 1.1 Strategjia Kombëtare për Zhvillim

**Kosova do të miratoj Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH).** SKZH do të shërbejë si mënyrë e paraqitjes së vizionit afatgjatë të vendit dhe krijimit të konsensusit kombëtar. SKZH do të zhvillohet në një kornizë gjithëpërfshirëse të planifikimit strategjik në drejtim të planifikimit afatmesëm në atë afatgjatë. Duke u bazuar në SKZH do të zhvillohen strategjitë sektoriale dhe horizontale në mënyrë koherente, të kostuara dhe në përputhshmëri me njëra tjetrën, duke mbështetur vizionin kombëtar dhe shërbyer si bazë e përcaktimit të politikave për procesin e KASH-it. Derisa SKZH mban fokusin në rritje dhe zhvillim ekonomik, funksioni parësor i saj do të jetë të siguroj se të gjitha synimet kombëtare, duke përfshirë integrimin Evropian reflektohen në mënyrën e duhur. SKZH do të identifikoj tregues të nivelit të lartë dhe do të shfrytëzoj monitorim të fokusuar për të përcaktuar nivelin e progresit të Kosovës drejt arritjes së synimeve afatgjata dhe afatmesme.

Si një mekanizëm për monitorim efektiv të SKZH-së me fokus në zbatim dhe jetësim të masave do të përgatitet një **Udhërrëfyes për Zbatimin e SKZH-së**. Ky do të jetë një dokument i standardizuar në kuadër të Udhërrëfyesit për Zbatimin e SKZH-së, i cili krahas planifikimit për vitin aktual duhet të përfshijë aspekte të mjaftueshme për tri vitet vijuese. Planifikimi vjetor sikurse aktualisht mund të reflektoj buxhetin e fundit të miratuar dhe të udhëzoj aktivitetet përkatëse, ndërsa aspektet për vite tjera do të udhëzojnë propozimet për KASH. Zbatimi i masave të SKZH-së do të bëhet përmes aranzhimeve të reja të llogaridhënies. Do të shtroj nevojën e një qasje që vendos theksin në zbatim dhe rezultate, si dhe performancë dhe menaxhim të bazuar në rezultate.

**Miratimi një dokumenti afatgjatë si SKZH padyshim se do të shënonte një zhvillim të sistemit të planifikimit të politikave dhe monitorimit në Kosovë.** Si i tillë është një hap i rëndësishëm drejt vendosjes të orientimit strategjik në mënyrë që planifikimi qeveritar të jetë më i fokusuar. Edhe pse SKZH si e tillë nuk mund të paraqes zgjidhje universale, në realitet në mënyrë që efektet e saj të vihen në pah do të ketë nevojë për disa veprime/reforma plotësuese dhe qasje të re të menaxhimit, që në rastin më të mirë mund të përfshijnë

- **Strategjitë sektoriale duhet të vendosin masat e SKZH-së si prioritete të nivelit të lartë**, duke i renditur prioritetet tjera sektoriale në nivel më të ulët. Në këtë drejtim konsiderohet e nevojshme që portofolet e njëjta të përcaktojnë detajet e kostos përmes instrumentit 3 vjeçar të KASH-it.
- **Buxheti/KASH është me rëndësi që të lëvizë drejt strukturës së bazuar në programe të KASH-it dhe buxhetit vjetor së paku në lidhje me programet e SKZH-së/strategjive sektoriale**, për të mundësuar përputhjen reale të kufijve dhe ndarjeve buxhetore me objektivat specifike të SKZH-së/strategjive sektoriale.
- **Në aspektin e zbatimit, konsiderohet se një zhvillim i sistemit të monitorimit duke kaluar në zbatim dhe jetësim të prioriteteve**, që së paku për monitorimin e SKZH-së do të vendoste vëmendjen në arritjen e produkteve treguesve të performancës së SKZH-së (aktualisht monitorimi fokusohet kryesisht në aktivitete dhe afate kohore). Përdorimi i të dhënave të tilla nuk duhet të kufizohet në raportime periodike, por gjithashtu të shfrytëzohet për identifikimin dhe zgjidhjen e pengesave në realizimin e real.

- *SKZH duhet të adresoj pengesat specifike të rritjes ekonomike të Kosovës – duhet të bazohet në një numër të vogël të prioriteteve, në atë mënyrë që burimet e nevojshme të kenë ndikim domethënës.*
- *Prioritetet e SKZH-së duhet të jenë të shkallës më të lartë të hierarkisë dhe të kenë përparësi ndaj të gjitha politikave në dokumente të tjera - pjesa tjetër e prioriteteve duhet të adresohet përmes strategjive sektoriale.*
- *Ministrat dhe institucionet përgjegjëse për prioritetet e SKZH-së duhet të prodhojnë udhërrëfyes të qartë për atë se çfarë do të bëjnë për arritjen e cive të SKZH-së. Këto dokumente duhet të trajtohen si zotime publike para Kosovarëve dhe t'i prezantohen partnerëve zhvillimor.*
- *Veprimet e SKZH-së duhet të gëzojnë mbulim të plotë financiar, qasje preferenciale ndaj burimeve të tjera nga buxheti kombëtar dhe/ose partnerët ndërkombëtar zhvillimor. Për ta bërë këtë në mënyrë transparente, prioritetet e SKZH-së duhet të futen në KASH dhe buxhet vjetor me prioritet të lartë.*

## 1.2 Konsolidimi i Kornizës së Strategjive Sektoriale

Raporti hierarkik ndërmjet SKZH-së të natyrës afatgjate dhe strategjive sektoriale është shumë i rëndësishëm. Idealisht, zbatimi i prioriteteve të SKZH-së duhet të kalojë përmes prioriteteve më të larta të strategjive sektoriale, të cilat do të funksionalizohen përmes KASH-it, buxhetimit vjetor dhe planifikimit vjetor të punës.

**Korniza e strategjive sektoriale duhet të konsolidohet.** Konsolidimi i dokumenteve të strategjive sektoriale do të jetë hapi i parë për përmirësimin e planifikimit sektorial. Me më tepër se 80 strategji sektoriale dhe nivele të tjera të dokumenteve planifikuese, ekziston një prirje e lartë e fragmentimit, mospërputhje dhe presion të qartë nga poshtë-lartë që rezultojnë me plane jo-reale të cilat nuk janë të prioritizuara në mënyrë të mirëfilltë. Strategjitë sektoriale do të jenë themeli i sistemit të ri, duke integruar planifikimin e politikave dhe atë financiar dhe duke lidhur planifikimin afatgjatë dhe afatmesëm me procesin e buxhetit. Prezantimi i SKZH-së duhet të iniciojë një proces shumëvjeçar të rivlerësimit dhe përshtatjes së strategjive sektoriale ekzistuese (nëse është e nevojshme) ose udhëzimin e ministrive për zhvillimin e strategjive të reja në përputhshmëri me qasjen e SKZH-së.

Nga një perspektivë e tillë, hendeku në planifikimin mbarë sektorial duhet të adresohet pas aprovimit të SKZH-së. Institucionet që akoma nuk kanë një qasje të unifikuar duhet të konsolidojnë dokumentet kryesore të tyre dhe ato që e kanë bërë këtë duhet ti avancojnë strategjitë sektoriale duke i përshtatur prioritetet e SKZH-së. Ky harmonizim është i nevojshëm për aspekte të SKZH-së që mund të konkurrojnë kundrejt “prioriteteve” më të ulëta; po ashtu

mund të përfitojnë portofolat jo-prioritare duke eliminuar tepricën nga planifikimi i dyfishuar ose të tejkaluara.

### 1.3 Veprimet

#### Gjatë vitit 2015,

1. **Të vendosen dhe miratohen kriteret se çfarë mund të konsiderohet strategji sektoriale.** Kjo duhet të kufizohet në rreh 20-25 strategji. Të tjerat mund të quhen “plane”, “programe”, ose diçka të ngjashme.
2. **ZPS zhvillon udhëzimet për përgatitjen e strategjive sektoriale të konsoliduara.** Kjo duhet të synoj ndryshimin e strategjive sektoriale në dokumente që ofrojnë prioritet të fokusuara, masa konkrete dhe të kostuara, të cilat mund të përfshihen lehtësisht në KASH.
3. **Strategjitë e reja sektoriale të përgatiten/pilotohen për dy ose tre sektorë bazuar në qasjen e SKZH-së dhe udhëzimet e reja.**
4. ***Të vlerësohet nevoja për rishikimin e strategjive sektoriale ose përgatitjen e strategjive të reja.*** Një vlerësim i përbashkët nga ZPS, MF, dhe MIE dhe secila ministri e linjës gjatë dhjetorit 2015, duhet të përcaktoj mangësitë specifike të politikave dhe kapaciteteve dhe nivelin e përpjekjeve dhe asistencës teknike të nevojshme për të përmbushur të gjitha kërkesat e SPI-së, duke përfshirë strategjitë sektoriale. Plani gjithashtu mund të informohet nga cilësia e propozimeve të KASH-it 2016-2018 dhe strategjive sektoriale. Një plan për rishikimin e strategjive sektoriale mund të përfundohet deri në fund të vitit 2015.

#### Gjatë vitit 2016 dhe 2017,

5. ***Të përgatiten strategji sektoriale (sa më shumë që e mundur gjatë vitit 2016) për pjesën tjetër të sektorëve.*** Duhet të vihet theksi në ato ministri që kanë nevojë për asistencë për të kompletuar strategji të plota sektoriale

## 2. Përmirësimi i Procesit të Vendimmarrjes

**Sistemi dhe proceset ekzistuese të planifikimit nuk i mundësojnë Kryeministrin dhe Ministrave përcaktimin e drejtimit strategjik që nga fillimi i procesit.** Kundrejt kësaj, produktet e përfunduara arrijnë shumë vonë për shqyrtim të hollësishëm në Qeveri. Vendimet kryesore shpesh merren në mënyrë të paplanifikuar (ad hoc) dhe të pa mbështetura nga një proces i shëndosh i planifikimit dhe diskutimit të politikave. Me futjen e sistemit të ri të propozuar, do të shtohen kërkesat ndaj vendimmarrësve për planifikimin strategjik. Sistemi do të synojë që vendimmarrësit të jenë më mirë të informuar dhe të angazhohen që nga fillimi i procesit të diskutimit të politikave.

**Implikimi kryesor i sistemit të ri të planifikimit për vendimmarrësit është nevoja që qeveria të marr një rol më strategjik dhe të angazhohet në faza të hershme të procesit të planifikimit.** Për shembull, Kryeministri (në emër të qeverisë) duhet të vendos prioritetet strategjike brenda kontekstit të vlerësimit makroekonomik para caktimit të kufijve të shpenzimeve të KASH-it, dhe në të njëjtën mënyrë për vendimet për ndarjen/alokimin e investimeve publike, financimin nga donatorët, etj.

**Objektivi kryesor në kuadër të këtij komponenti është përmirësimi i koordinimit të politikave, vendimmarrjes dhe drejtimit strategjik si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin e ministrive të linjës.**

### *(i) Përmirësimi i koordinimit të politikave dhe procesit të vendimmarrjes në nivelin qendror të Qeverisë*

Për momentin ekzistojnë dy komisioni strategjike të nivelit të lartë: **(i) Komisioni për çështje fiskale dhe buxhetore** dhe **(ii) Komisioni për Investime Publike**. Këto komisione ekzistojnë formalisht për më tepër se tri vite, por deri më tani nuk kanë qenë plotësisht funksionale. Struktura aktuale dhe funksionet e këtyre dy komisioneve kufizohet për disa arsye: së pari fokusi parësor (pothuajse ekskluziv) në procesin buxhetor paraqet kufizime në përfshirjen e tyre në koordinimin e politikave dhe vendimmarrje; së dyti, të dy komisionet mbështeten nga mekanizma të dobët të koordinimit ndërinstytucional; dhe së treti, në aspektin praktik punimet e këtyre dy komisioneve nuk bazohet në një kalendar të qartë dhe të strukturuar mirë.

Për të adresuar këtë, propozohet riorganizimi i këtyre dy komisioneve përmes shkrirjes në një strukturë të vetme<sup>2</sup> dhe ti disa shtohen disa funksione lidhur me prioritizimin strategjik të politikave dhe procesin e vendimmarrjes.

- **Në nivelin qendror rekomandohet krijimi i Komisionit për Planifikim Strategjik (KPS),** në nivelin e lartë për mbikëqyrjen dhe drejtimin e procesit të planifikimit të politikave dhe prioritizimit. Me këtë synohet përfshirja e Kryeministrin dhe nivelit më të lartë të vendimmarrjes dhe sigurimi i përkrahjes së plotë politike në proces, që është e minente për suksesin e këtyre reformave. KPS do të mbështetet përmes një kalendar të integruar vjetor (shiko seksionin tjetër) dhe në nivelin teknik nga një mekanizëm koordinues ndërinstytucional përmes Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS).<sup>3</sup>

<sup>2</sup> Emri mund të sugjerohet të ndryshohet, në mënyrë që të mos ngushtohet fokusi me ndonjë prej proceseve ekzistuese dhe së dyti, prapë mund të kuptohet si një risi që pritet të bëjë ndryshime në nivelin e lartë të koordinimit dhe vendimmarrjes.

<sup>3</sup> GDPS përbëhet nga përfaqësues të lartë të nivelit teknik të ZKM, MF, MIE, MAP dhe MZHE.

**Është me rëndësi të theksohet se komisioni i ri nuk duhet të konsiderohet si strukturë e re, por reformësim dhe funksionalizim i strukturave ekzistuese, dhe vënien e disa funksioneve shtesë. KPS pra do të zëvendës dy Komisionet e theksuara më lartë.**


*(ii) Përmirësimi i koordinimit të politikave dhe vendimmarrjes në nivelin e ministrive*

Me fuqizimin e koordinimit të politikave në nivelin qendror, sfida tjetër do të jetë përmirësimi (bazuar në qasjen e njëjtë) i procesit të koordinimit të politikave dhe vendimmarrjes në nivelin e ministrive të linjës.

- **Grupi për Menaxhim Strategjik (GMS)** sugjerohet të krijohet në secilën ministri të linjës.

Një Grup për Menaxhim Strategjik duhet të krijohet në kuadër të secilës ministri (duke pasqyruar qasjen e KPS, por në nivelin e secilës ministri të linjës). GMS duhet të kryesohet nga Ministri. Stafi i lartë i ministrisë do të formoj Grupin për të siguruar cilësinë e vendimmarrjes dhe monitorimin e zbatimit të planeve ministrore në kuadër të SKZH-së, agjendës së Integritimit Evropian për sektorin, Strategjitë Sektoriale, KASH-in, planet për investime publike dhe ndihmë të jashtme. GMS do të përfshihet në të gjitha vendimet kryesore të planifikimit para procedimit të mëtejshëm për shqyrtim dhe miratim në KPS dhe qeveri, duke përfshirë: përcaktimin e prioriteteve strategjike të sektorit dhe nismave të politikave të reja; miratimin e strategjive sektoriale/ndërsektoriale; përcaktimin e kufijve agregatë të sektorit dhe programeve para procedimit në MF; finalizimin dhe miratimin e propozimeve të sektorit për KASH/Buxhet vjetor; shqyrtimin dhe miratimin e kontributit të sektorit për PVPQ para dorëzimit në SKQ. Grupi duhet të drejtohet nga Ministri (ose Zëvendës Ministri në emër të tij/saj); i koordinuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe në përbërje të drejtorëve të departamenteve kryesore

**Organet politike dhe administrative**  
**Mbikëqyrja e procesit të planifikimit dhe koordinimit të politikave**



## 2.1 Veprimet

1. Qeveria themelon Komisionin për Planifikim Strategjik (KPS) – bazuar në reformësimin e Komisionit për çështje fiskale dhe buxhetore dhe Komisionit për Investime Publike – për tu kryesuar nga Kryeministrit dhe në përbërje të Zëvendës Kryeministrit (ve) dhe Ministrave kyç. Përcaktimi i rolit dhe përgjegjësisë dhe modaliteteve të funksionimit të tij.
2. Një kalendar integruar 12 mujor i planifikimit përgatitet paraprakisht duke përcaktuar aspektet kryesore të vendimmarrjes nga ana KPS-së;
3. Kryeministri nxjerr një vendim për krijimin e Grupit për Menaxhim Strategjik (GMS) për tu kryesuar nga ministri përkatës në secilën ministri të linjës

### 3. Integrimi i Procesit – Kalendarit i Planifikimit të Integruar

Në Kosovë ka prirje për të krijuar korniza autonome të planifikimit, secila me kërkesa të veçanta të procesit. Aktualisht ekzistojnë kalendarë individual për strategji kombëtare dhe sektoriale, KASH, buxhet vjetor, Integrim Evropian, planifikim legjislativ, monitorim të punës së qeverisë, etj. Secila kornizë e planifikimit zhvillon kalendarin në mënyrë të pavarur dhe korniza të caktuara përdorin periudha të ndryshme kohore dhe freskohen në periudha të ndryshme ose nuk freskohen fare.

**Objektiva në kuadër të Kalendarit të Integruar është vendosja e një kalendarit vjetor të planifikimit që në mënyrë efektive rendit të gjitha veprimet dhe pikat e vendimmarrjes duke rezultuar në integrimin e proceseve të ndryshme të planifikimit (në rastin më të mirë) ose harmonizimin maksimal (sipas mundësive).**

#### 3.1 Veprimet

##### Për vitin 2015 (për tu përsëritur secilin vit)

1. Të përgatitet një kalendar specifik për secilën komponentë të SPI-së, procesit qendror të planifikimit dhe buxhetimit në Kosovë (SKZH, KASH, Integrimi Evropian, PVPQ, etj.) në javët e para të janarit nga institucionet përkatëse qendrore (ZPS, SKQ, ZL, MIE, MF).
2. Në emër të GDPS-së, ZPS integron të gjithë kalendarët në një Kalendar të Integruar të Planifikimit për të gjitha proceset e planifikimit dhe buxhetimit, monitorimit në lidhje me proceset e vendimmarrjes në Kosovë.
3. Kalendarit i integruar prezantohet për miratim në takimin e parë të KPS-së për vitin aktual.

## 4. Planifikimi i Integrit Evropian

**Roli qendror i Integrit Evropian në SPI veç do të shtohet gjatë viteve të ardhshme.** Integriti Evropian do të jetë forca shtytëse e vizionit kombëtar dhe synimeve të politikave që mbulojnë SKZH-në dhe strategjitë sektoriale. Ky proces do të ndikoj në çdo sektor dhe identifikoj zotime të hollësishme nga shumica e ministrive. Për këtë qëllim kërkohet përpjekje e përbashkët nga Ministria e Integrit Evropian, ZKM/ZPS dhe Ministria e Financave për të ofruar plan të hollësishëm dhe metodologji mbi rolin përkatës të Integrit Evropian në SKZH dhe KASH dhe mekanizmat të integrit të komponentëve të ndryshëm të saj në proceset e përgjithshme të SPI-së.

**Korniza institucionale e planifikimit të Integrit Evropian tashmë është e vendosur.** Strukturat institucionale për menaxhimin e agjendës evropiane është relativisht e mirë, lidhshipi i MIE-së është në nivelin të kënaqshëm dhe nuk kërkon ndryshime të mëdha institucionale. Gjatë vitit 2015 mund të shtohen **dy aspekte të reja** në kornizën ekzistuese të planifikimit të Integrit Evropian:

- **Plani për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PZMSA)** i cili do të paraqet në hollësi veprimet për tu ndërmarr nga institucionet e Kosovës për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në; dhe
- **Programit Kombëtar të Republikës së Kosovë për Adoptimin e Acquis-së së BE-së<sup>4</sup>** përfaqëson inkorporimin e legjislacionit Evropian në legjislacionin e Kosovës. Si i tillë përfshinë amendamentin e nevojshëm të legjislacionit të Kosovës për t'i bërë në përputhshmëri me ligjet evropiane.

**Objektiva kryesore qëndron në reflektimin e plotë të agjendës së Integrit Evropian në të gjitha nivelet dhe fazat e planifikimit qeveritar.** duke njohur faktin se Integriti Evropian përfshinë kërkesa të veçanta të raportimit, dhe KE përcakton afatet kohore, secila përpjekje duhet të adresohet në atë mënyrë që harmonizon planifikimin dhe monitorimin e agjendës së Integrit Evropian me SKZH, KASH dhe PVPQ. Duke filluar nga viti 2016, të gjitha kërkesat e IE duhet të ndërlihen me dokumentet përkatëse planifikuese të ministrive dhe të reflektohet në prioritetet, synimet, objektivat, aktivitetet, produktet dhe buxhetin e tyre.

### 4.1 Veprimet

1. Planifikimi dhe vendimmarrja e Integrit Evropian të jenë të integruara plotësisht në kuadër të Sistemit për Planifikim të Integruar, duke njohur kërkesat e veçanta të këtij procesi. MIE dhe ZPS të përgatisin një vlerësim të sistemit të vendimmarrjes në kuadër të integrit Evropian dhe mënyrën se si mund të ndërlihen (nëse është e nevojshme) me arkitekturën e gjithmbarshme të SPI-së. IE të konsiderohet si aspekt qendror i vizionit kombëtar për zhvillimin e treguesve të nivelit të lartë të SKZH-së dhe strategjive sektoriale.
2. Agjenda e integrit Evropian të reflektohet plotësisht në të gjitha komponentët e Kalendarit për Planifikim të Integruar duke filluar nga viti 2015.
3. Rishikimi i kalendarit të integrit Evropian, duke përfshirë aspektet kryesore të vendimmarrjes ku kërkohet vendimmarrja nga KPS/KM
4. Përgatitja e Planit për Zbatimin e MSA-së gjatë vitit 2015
5. Programit Kombëtar të Republikës së Kosovë për Adoptimin e Acquis-së së BE-së (PKAA).

<sup>4</sup> Ministria e Integrit Evropian synon të përgatis këtë plan duke u bazuar në përvojën e të gjitha vendeve kandidate për anëtarësim. Megjithatë, nuk është marr vendim përfundimtar për këtë.



## 5. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve/Buxheti Vjetor

Kosova ka bërë të dukshëm në përmirësimin e procesit të planifikimit buxhetor. Përkundër progresit të dukshëm, është e nevojshme të punohet në përmirësimin e përkthimit të prioriteteve kombëtare dhe sektoriale në KASH dhe buxhetin vjetor. Ndërlidhja ndërmjet KASH/ buxhetit vjetor me strategjitë mund të përmirësohet dhe të bazohet në një proces efektiv të prioritizimit dhe vendimmarrjes. Kjo po ashtu ndërlidhet me përmirësimin e mundësisë së kostimit dhe prioritizimit të politikave. Natyra e ndryshimeve të propozuara lidhur me përmirësimin e kornizës planifikuese të KASH-it dhe planifikimit të buxhetit vjetor është gjithëpërfshirëse.

### Objektivat kryesore në kuadër të këtij komponenti përfshijnë:

- **Përmirësimi i vendimmarrjes në lidhje me KASH/Buxheti vjetor.** Kryeministri dhe vendimmarrësit tjerë të nivelit të lartë duhet të angazhohen aktivisht që nga fillimi i procesit të planifikimit të KASH-it/Buxhetit. Themelimi i Komisionit për Planifikim Strategjik (shiko kapitullin për vendimmarrje) dhe roli i tij në politikave prioritare të KASH-it, dhe kufijve ministror/sectorial duhet të paraqes një zhvillim pozitiv në këtë proces.
- **Përmirësimi i orientimit strategjik të KASH-it/buxhetit.** Ndërlidhja ndërmjet KASH-it dhe dokumenteve strategjike sektoriale duhet të përmirësohet; me vendosjen e SKZH-së dhe rishikimin ose miratimin e strategjive të reja sektoriale pritet një përmirësim i proces; me theks të veçantë në vitin 2016 t duhet të vihet theksi në harmonizimin e Integritimit Evropian dhe reflektimin e Programit të Qeverisë në KASH.
- **Përmirësimi i strukturës së KASH-it/buxhetit. Një strukturë e re e buxhetit bazuar në programe duhet të prezantohet;** kjo duhet të përfshijë lidhjen e kufijve të shpenzimeve të KASH-it me politikat prioritare të programit, objektivat, produktet, treguesit/caqet e rezultateve, dhe aktivitetet, për periudhën tre vjeçare. Kufijtë e shpenzimeve të ministrive/sectorëve duhet të zërthehen më tutje nga kufijtë sectorial në kufijtë e nivelit të programeve.
- **Përmirësimi i mëtejshëm i konsistencës ndërmjet sistemit të BDMS dhe PIP.** Deri më tani janë bërë hapa të rëndësishëm në harmonizimin e sistemeve BDSMS dhe PIP. Futja e buxhetimit të bazuar në programe mund të kërkoj një konsiderim të mëtejshëm, duke qar drejt një softueri të integruar të planifikimit të buxhetit bazuar në procedurat e reja (te theksuara më lartë) dhe strukturën programore të buxhetit. Nevoja për një sistem të tillë mund të ketë nevojë të shqyrtohet më tutje.
- **Përmirësimi i ciklit dhe kalendarit të planifikimit të KASH/Buxhet vjetor.** Një opsion që mund të konsiderohet është shqyrtimi i mundësisë për futjen e procesit “me dy rraunde/cikle” të përgatitjes së KASH-it/Buxhetit vjetor. Kjo do të kërkonte që faza përfundimtare (cikli i dytë) e miratimit të KASH-it do të bëhej në fund të kalendarit buxhetor (shtator), në të njëjtën kohë me miratimin e buxhetit vjetor. Kjo do të mundësonte që kufijtë e KASH-it dhe (nëse është e nevojshme) prioritetet të rishikohen në përputhshmëri me rishikimet e parashikimeve makro-fiskale në qershor (rishikimi i gjashtëmujorit), por gjithashtu, nëse kërkohet, në shtator kur përfundohet cikli i plotë i buxhetit para miratimit në qeveri. Duke marr parasysh se kjo kërkon ndryshime në legjislacionin ekzistues, ky opsion duhet të shqyrtohet me kujdes dhe në rast të një vendimi pozitiv veprimet e mundshme mund të ndërmerren në vitin 2016 me efekt në ciklin e planifikimit të vitit 2017.
- **Fuqizimi i përfshirjes së stafit të lartë drejtues të ministrive në procesin buxhetor, mbikëqyrjen dhe monitorimin e të gjitha proceseve të planifikimit të politikave dhe atij financiar si pjesë fundamentale e përgjegjësisë të tyre.** Një Grup për Menaxhim Strategjik (shiko kapitullin për vendimmarrje), i kryesuar nga ministri, të formohet në

secilën ministri të linjës dhe të jetë përgjegjës për të gjitha vendimet lidhur me KASH/buxhet vjetor në ministrinë përkatëse.

### 5.1 Veprimet

Në vijim paraqitet një numër i veprimeve të rekomanduara që mund të realizohen gjatë periudhës 2015-2017, që mund të kenë ndikim në KASH në përputhshmëri me zbatimin e SPI-së.

#### Në vitin 2015

1. Rishikimi i kalendarit të KASH-it/Buxhetit vjetor, paraqitja i aspekteve kryesore të vendimmarrjes ku përfshihen vendimet e KPS/KM.

#### Në vitin 2016

1. Pilotimi i strukturës së re programore të buxhetit<sup>5</sup> në dy ose tri ministri, duke shfrytëzuar forma të veçanta të propozimeve buxhetore<sup>6</sup>
2. Të përgatiten udhëzimet e reja për përgatitjen e KASH-it/buxhetit vjetor bazuar “strukturën e programeve”, për tu aplikuar në ciklin e vitit 2016.
3. Përfshirja e plotë prioriteteve të SKZH-së, dhe Planit për Zbatimin e MSA-së në KASH 2017-2019
4. Përmirësimi i kostimit të produkteve të SKZH, Planit për Zbatimin e MSA-së për tre vitet e para të KASH-it.
5. Të vlerësohet mundësia e futjes së procesit të përbërë nga “dy runde/cikle” për përgatitjen e KASH-it. Kjo do të nënkuptonte që miratimi përfundimtar i KASH-it duhet të bëhet në fund të procesit të planifikimit të buxhetit (shtator-tetor).
6. Vala e parë e rishikimit të strategjive sektoriale të informoj përgatitjen e përcaktimit të kufijve të KASH-it.
7. Ndhima e jashtme të reflektohet në KASH dhe buxhet vjetor.

#### Në vitin 2017

1. Struktura e re buxhetit sipas programeve e shtrirë në të gjitha ministrinë e linjës ose (vala e dytë) në një numër të caktuar të ministrive të linjës
2. Ofrimi i trajnimeve të nevojshme për MF/Departamentin e Buxhetit dhe Ministrinë e linjës lidhur me “strukturën e buxhetit sipas programeve” dhe procedurat përcjellëse
3. Zbërthimi i kufijve të KASH-it/buxhetit vjetor nga niveli i sektorit edhe në nivel të programeve. Prezantimi i kufijve të shpenzimeve rrjedhëse dhe kapitale edhe në nivel të programeve për të gjitha ministrinë.
4. Përfshirja prioriteteve të rishikuara të SKZH-së, dhe Planit për Zbatimin e MSA-së në KASH 2018-2020
5. Përmirësimi i kostimit të produkteve të rishikuara të SKZH, Planit për Zbatimin e MSA-së për tre vitet e para të KASH-it.
6. Vala e dytë e rishikimit të strategjive sektoriale të informoj përgatitjen e përcaktimit të kufijve të KASH-it.

<sup>5</sup> Në seksionet e mëparshme është propozuar që një “strukturë programore” po ashtu aplikohet në udhëzimet për përgatitjen e strategjive të reja sektoriale. Dy apo tri strategjitë e propozuara për tu pilotuar po ashtu gjatë vitit 2016 duhet të përshtatin strukturën e njëjtë të programeve sikurse në KASH/Buxhet.

<sup>6</sup> Një prej kërkesave kryesore për futjen e strukturës së programore të buxhetit është integrimi procedurave të shpenzimeve rrjedhëse dhe kapitale. Kjo mund të jetë e vështirë të bëhet përmes tipareve ekzistuese të BDSM dhe PIP. Për këtë qëllim forma të reja për propozime të buxhetit duhet të paraqiten dhe aplikohen.

## 6. Programimi i Investimeve Publike

**Sistemi ekzistues i Programit për Investime Publike (PIP) në Kosovë paraqet një sistem të kënaqshëm për vlerësimin e projekteve dhe (së paku në parim) për prioritizimin e projekteve, por duhet të ndërlihet në mënyrë më efektive me pjesën tjetër të planifikimit dhe procesit të prioritizimit strategjik.**

Është me rëndësi që procesi i planifikimit dhe prioritizimit të investimeve publike të ri-organizohet nga këndvështrimi i arkitekturës së SPI-së. Qeveria duhet të zbatoj një proces të revitalizuar të planifikimit dhe menaxhimit për Investimet Publike që i harmonizon më mirë propozimet me prioritetet e qeverisë dhe strategjitë sektoriale. Projekte të përshtatshme duhet të identifikohen qysh në fillim të ciklit të planifikimit.


**Objektiva kryesore në kuadër të këtij komponenti është fuqizimi i ndërlidhjes ndërmjet projekteve të investimeve publike me prioritetet e SKZH-së dhe strategjitë sektoriale përmes një dialogu dhe procesi të konsistent të prioritizimit, si pjesë përbërëse e planifikimit të KASH-it/buxhetit vjetor.**

Në kuadër të kësaj propozohen dy përmirësime kryesore të proceseve:

- i. **Procedura të rishikuara të PIP-it** të cilat sigurojnë që propozimet për investime publike identifikohen përmes proceseve të planifikimit strategjik në kuadër të SPI-së (SKZH/strategjitë sektoriale/KASH);
- ii. **Procesi dhe procedurat të vendimmarrjes për investime publike të rishikohen, në harmoni me arkitekturën e SPI-së.** Vendimet për alokimin e projekteve për investime publike duhet të përfshijnë Kryeministrin, përkatësisht Komisionin për Planifikim Strategjik në një fazë të hershme të planifikimit, duke u bazuar në procesin e hershëm të shqyrtimi/prioritizimit fillimisht nga MF dhe pastaj nga GDPS. Një “proces i përbërë nga tri faza për shqyrtimin e investimeve publike” mund të konsiderohet; shqyrtimi i parë nga MF, i dyti nga GDPS dhe shqyrtimi i tretë dhe i miratimi përfundimtar nga KPS (më tepër detaje do të ofrohen në këtë seksion).

Diagrami më poshtë ilustron procesin e shqyrtimit të investimeve publike përmes të cilit projekteve përkatëse i bëhet kontrolli i cilësisë dhe shqyrtimet buxhetore.

**Figura: Shqyrtimi dhe Miratimi për Projektet e Investimeve Publike**



## 6.1 Veprimet

Veprimet në vijim rekomandohen të ndërmerren gjatë periudhës 2015-2016

1. Planifikimi i investimeve publike të kaloj nga forma projekt-për-projekt në prioritizim të bazuar në politika sektoriale, ku investimet publike identifikohen drejt realizimit të objektivave të politikave të SKZH-së/strategjive sektoriale përmes procesit të KASH-it/buxhetit vjetor.
2. Përmirësimi i procedurës së përzgjedhjes në PIP, duke inkurajuar një fazë të hershme dhe proaktive të identifikimit dhe përzgjedhjes së projekteve, ku projektet e investimeve publike dorëzohen për shqyrtim dhe miratim para vendimmarrjes për KASH/buxhetin vjetor dhe financimin e jashtëm.
  - i. Rishikimi procedurave të shqyrtimit në kuadër PIP, duke mundësuar “proces shqyrtimi të përbërë nga tri faza” (MF-GDPS-KPS) para përfundimit të KASH-it/Buxhetit vjetor dhe vendimeve të qeverisë.
  - ii. Shqyrtimi i parë realizohet nga MF/Departamenti i Buxhetit (analistët e buxhetit), sikurse për procesin ekzistues.

- iii. Zhvillimi i procedurave për GDPS - “shqyrtimi i nivelit të dytë” (roli i GDSP-së do të ishte “filtrimi” i atyre projekteve që duhet të kalojnë në fazën e tretë të shqyrtimit, shqyrtimi nga KPS
3. Procedura të veçanta të zhvillohen për KPS “niveli i tretë i shqyrtimit” për miratimin e projekteve me kosto ose prioritet të lartë
    - i. Kriteret të zhvillohen për të përcaktuar se kur një projekt për investime publike i kushtueshëm, i diskutueshëm ose kompleks (me financim të jashtëm ose nga donatorët) kërkon shqyrtim të thellë nga KPS para miratimit në qeveri. Projektet e mëdha, përtej kapaciteteve të ministrive për tu financuar brenda kufijve të investimeve publike në KASH, të konsiderohen nga KPS/qeveria para miratimit dhe të reflektohen në kufijtë e shpenzimeve të KASH-it, ose vendime ad-hoc të qeverisë..
  4. Përmirësimi i procedurave për përgatitjen e një “Liste të Projekteve të Investimeve Publike” për financime të mëtutjeshme. Lista nuk duhet të kërkojë procedura të reja ngase sistemi i PIP mundëson identifikimin e kësaj liste. Lista e projekteve të investimeve publike duhet të pasqyrojë prioritetet e Kosovës në investime publike dhe që kërkojnë financim të brendshëm ose nga donatorët në ciklin e ardhshëm të politikave dhe buxhetit.

## 7. Menaxhimi i ndihmës së jashtme

**Planifikimi i ndihmës së jashtme është menaxhuar pothuajse një mënyrë të fragmentuar dhe nuk është bazuar në një proces përgatitor të prioritizimit.** Procesi i alokimit të fondeve të jashtme shpesh është i pa strukturuar (ad hoc) ose i orientuar nga donatorët. Është esenciale që procesi i planifikimit dhe prioritizimit të projekteve të financuara nga donatorët të riorganizohet në përputhshmëri me arkitekturën e re të SPI. Qeveria duhet të zbatoj një sistem të revitalizuar për planifikimin dhe menaxhimin e ndihmës së jashtme që harmonizon fondet e donatorëve me prioritetet e SKZH-së, strategjive sektoriale, Planit për Zbatimin e MSA-së, PKAA, identifikon projekte të përshtatshme fazat e hershme të ciklit të planifikimit, përmirëson cilësinë e vlerësimit, dhe përmirëson shkallën e disbursimeve aktuale krahas atyre të planifikuara.


**Objektiva kryesore në kuadër të këtij komponenti është vendosja e një procesi të planifikimit që në mënyrë efektive integron fondet e jashtme me prioritet e qeverisë dhe KASH.**

Veprimet në vijim do të mund të konsiderohen për të përmirësuar menaxhimin e ndihmës së jashtme në përputhshmëri me përmirësimin e arkitekturës së planifikimit. Një sistem gjithëpërfshirës i planifikimit dhe menaxhimit të ndihmës së jashtme duhet të zbatohet në harmoni me proceset e SPI-së, duke ndryshuar qasjen e planifikimit të ndihmës së jashtme nga qasje projekt-për-projekt në baza të politikave sektoriale ku projektet identifikohen me qëllim të realizimit të politikave prioritare të SKZH/strategjive sektoriale dhe fuqizimin e prioriteteve strategjike në kuadër të KASH-it.

- Përmirësimi i strukturës institucionale dhe procedurave për fuqizimin e menaxhimit të ndihmës së jashtme dhe vendimmarrjes, në përputhshmëri me arkitekturën e SPI-së.
- Procedura të reja për menaxhimin e ndihmës së jashtme që sigurojnë se projektet propozimet e financuara nga donatorët janë identifikuar dhe rishikuar përmes proceseve të planifikimit strategjik të qeverisë;
- Vendimet për alokimin e projekteve të financuara përmes fondeve të jashtme të ndjekin qasjen e njëjtë sikurse për PIP “të përbërë nga tri faza shqyrtuese” (shiko më poshtë detaje të tjera).

Diagrami më poshtë ilustron procesin e shqyrtimit të projekteve të ndihmës së jashtme përmes të cilit projektet e veçanta i nënshtrohen kontrollit të cilësisë dhe kontrollit buxhetor. Ky proces synon të përfshijë projektet potenciale dhe të krijoj bazën për një listë të projekteve që mund të negociohen për financim nga donatorët.

**Figura: Procesi i shqyrtimit dhe miratimit të projekteve të financuara nga donatorët**



Tre elemente të reja duhet të shtohen në ciklin e shqyrtimit dhe miratimit të projekteve të financuara përmes partnerëve zhvillimor:

- **Së pari, pas vlerësimit fillestar të MIE-së, projekt propozimet duhet të shqyrtohen nga Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS)**<sup>7</sup>. Në kuadër të shqyrtimit nga GDPS: ZPS vlerëson nëse projektet propozimet janë në përputhshmëri me prioritetet e SKZH-së/Strategjive sektoriale; MIE kontrollon përputhshmërinë e tyre me prioritetet e integritimit Evropian dhe/ose dyfishimit me fonde të donatorëve të tjerë; ndërsa MF shqyrton projektet në pikëpamje të hendekut financiar të KASH-it, si dhe efikasitetit (vlerës për para), hapësirës fiskale për bashkëfinansim dhe implikimet në shpenzimet rrjedhëse.
- **Programet e donatorëve ose Marrëveshjet për Financim** (programi vjetor i IPA-së, ose portofoli vendor i Bankës Botërore, etj.), duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit përfundimtar nga KPS, para miratimit përfundimtar të Qeverisë (ose Kuvendit në raste të huamarrjes).
- **Një “Listë e Projekteve të Ndihmës së Jashtme”<sup>8</sup> duhet të përgatitet dhe rishikohet çdo vit.** Projektet për të cilat kërkohet financim duhet të kanalizohen në “Listën e

<sup>7</sup> GDPS përbëhet nga përfaqësuesit e ZKM-së, MIE, MF, MAP dhe MZHE.

<sup>8</sup> Shpesh e quajtur “Strategjia për ndihmën e jashtme”

projekteve të ndihmës së jashtme” për diskutim të mëtejshëm dhe negociim me donatorë. Dokumenti i Listës së Projekteve të Investimeve Publike dhe Ndhmës së Jashtme” duhet të përgatitet dhe freskohet në baza vjetore në fund të procesit të KASH-it/buxhetit vjetor. Dokumenti duhet të shfrytëzohet për negociata të mëtejshme me donatorët.

Propozimi – shqyrtimi – miratimi i projekteve me financim të brendshëm dhe të jashtëm duhet të jetë një cikël i plotë vjetor. Në parim, ministritë mund të aplikojnë për projekte të reja tek MF dhe MIE çdo kohë gjatë 12 muajve të vitit.

## **7.1 Veprimet**

### **Gjatë vitit 2015**

1. Rishikimi i rregullave ose procedurave për menaxhimin e ndihmës së jashtme.
2. Aplikimi i procedurave të reja për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve të financuara nga partnerët zhvillimor, bazuar në arkitekturën e SPI-së, duke përfshirë:
  - i. Të rishikohen procedurat për shqyrtimin e projekteve të ndihmës së jashtme, duke mundësuar “proces shqyrtimi të përbërë nga tri faza” (MIE(+)/GDPS/KPS);
  - ii. Të zhvillohen procedura për GDPS – “faza e dytë e shqyrtimit/filtrimi i projekteve”
  - iii. Të zhvillohen procedura për KPS “faza e tretë e shqyrtimit”
  - iv. MF/MIE të përcaktojnë procedurat për identifikimin e “hendekut të financimit” në fund të procesit të KASH-it dhe nevojat për financim nga donatorët
3. Të zhvillohen metodologjitë, standardet dhe formatet për të udhëzuar ministritë e linjës në procesin e përgatitjes dhe dorëzimit të projekteve (fazat e identifikimit, fizibilitetit dhe vlerësimit).

### **Gjatë vitit 2016**

4. Një Dokument vjetor për Projektet e Ndhmës së Jashtme të përgatitur duke paraqitur prioritetet e Kosovës për ndihmë të jashtme dhe identifikimin e projekteve potenciale që kërkojnë financim nga donatorët në përkrahje të prioritetëve strategjike të qeverisë. Dokumenti duhet të ndërlihet dhe në rastin më të mirë të jetë pjesë përbërëse e Listës së Projekteve të Investimeve Publike.
5. Të përgatitet një raport vjetor duke paraqitur rezultatet e arritur kundrejt rezultateve të pritura dhe kontributet e ndihmës së jashtme.

## 8. Monitorimi i integruar – llogaridhënia dhe zbatimi

**Parimet e planifikimit dhe monitorimit të integruar kërkojnë vendosjen e një Sistemi të Integruar të Menaxhimit të Informatave që do të mbulonin të gjitha zotimet qeveritare dhe të ministrive të linjës.** Edhe pse gjatë vitit qeveria pranon raporte të rezultateve nga burime të ndryshme (SKQ, ZPS, MIE, MF), monitorimi nuk është gjithmonë i lidhur me ciklin e planifikimit. Janë bërë përpjekje të mira gjatë viteve të fundit për të përmirësuar sistemet e monitorimit dhe raportimit në Kosovë. Janë vendosur disa Sisteme për Menaxhimin e Informatave, duke përfshirë: Sistemin e Menaxhimit të Informatave të PVPQ-së, atë për vendimet e Qeverisë; Sistemi për monitorimin e programit legjislativ; Sistem i Menaxhimit të Informatave për Planin e Veprimit për Liberalizimin e Vizave. Megjithatë, kjo shpërndarje ka qar në monitorim të fragmentuar të ministrive të linjës nga ana e institucioneve të shumta të nivelit qendror duke përdorur formate të ndryshme dhe jo-konsistente. **Të gjitha këto sisteme funksionojnë në mënyrë të pavarur me ndërlydhje të kufizuar ose integrim të sistemeve e elektronike me njëri tjetrin.** Ekzistenca e shumë sistemeve shton ngarkesën tek ministrinë e linjës të cilat duhet të ofrojnë informata për raportim brenda periudhës së njëjtë (kryesisht në baza periodike/tremujore) në sisteme të ndryshme. Nëse nuk adresohet, kërkesat e tepërta të monitorimit dhe organizimi joefikas i këtij funksioni do të ndikoj negativisht në performancën e ministrive.

**Sistemet informative të SKQ-së duhet të shfrytëzohen si sisteme ekskluzive për të mbuluar dhe monitoruar performancën e institucioneve qeveritare.** Monitorimi i PVPQ-së ka funksionuar mjaft mirë deri më tani, por nevojiten përmirësime të mëtejshme për tu bërë një mekanizëm që do të ofronte produkte më cilësore tek niveli i lartë menaxhues i Qeverisë së Kosovës sa i përket zbatimit të programit të qeverisë. Raportet e PVPQ-së duhet të fokusohen më tepër në aspekte cilësore të performancës. PVPQ duhet të përmirësoj informatat/treguesit lidhur me performancën ndaj arritjes së politikave prioritare ose synimeve që i përkasin ato masa, kështu duke i mundësuar input më cilësor për nivelin politik të vendimmarrjes.

Zgjerimi i sistemit të raportimit dhe monitorimit të PVPQ-së për të mbuluar të gjitha kornizat e planifikimit nuk pengon zhvillimin e sistemeve (baza të të dhënave) të tjera ku ekzistojnë kërkesa të veçanta monitorimi, sikurse Sistemi i monitorimit të agjendës Evropiane, Platforma për Menaxhimin e Ndihmës së Huaj, PIP dhe softueri për përgatitjen e buxhetit. Në parim zhvillimi sistemeve paralele duhet të dekurajohet. Sidoqoftë, duhet të pranohet se për një kohë disa monitorime paralele do të ekzistojnë të funksionojnë të në mënyrë të pavarur. Për shembull, monitorimi i agjendës evropiane do të merr kohë për tu integruar plotësisht në sistemin e monitorimit dhe raportimit për PVPQ. Kjo për shkak të kontekstit shumë specifik të procesit të integritimit Evropian; dinamikës së raportimit tek KE; strukturës institucionale (i tërë procesi i integritimit Evropian menaxhohet në një cikël të mbyllur plotësisht nga MIE, ku ZKM dhe MF pothuajse nuk kanë përfshirje). Si rrjedhojë duhet të kihet parasysh në sinergjitë dhe dyfishimet ndërmjet Sistemit të raportimit dhe monitorimit të PVPQ-së dhe sistemet tjera të monitorimit. Aty ku është e mundshme këto sisteme duhet të integrohen, por nëse nuk ka mundësi, duhet të synohet harmonizimi maksimal i tyre.

**Objektiva kryesore** në kuadër të këtij komponenti është vendosja e një Sistemi të Integruar të Monitorimit për t'i siguruar qeverisë informata të monitorimit të nevojshme për të përcjellë zotimet kryesore të qeverisë (duke përfshirë të gjitha iniciativat e dakorduara të integritimit Evropian) dhe t'i ofrojë menaxhmentit të ministrive informata gjithëpërfshirëse mbi realizimin e planeve operative të ministrive.



Intervenimet e propozuara përfshijnë:

- i. Zhvillimin e Planit Ministror i Monitorimit të Integruar. Raportet nuk duhet të dallojnë në strukturë dhe qasje nga metodologjia aktuale e PVPQ-së, përkundrazi duhet të bëhen pjesë përbërëse e procesit të PVPQ-së. duhet të ketë më tepër fokus në monitorimin e sektorit/ministrisë dhe të synoj integrimin e të gjitha kërkesave të monitorimit për ministrinë/sectorin përkatës. Në parim kjo nuk duhet të përbëjë punës shtesë për ministrinë e linjës, nga ajo ato duhet të bëjnë për përgatitjen e PVPQ-së.
- ii. Integrimi dhe komunikimi i përmirësuar ndërmjet Sistemeve informative të SKQ-së/PVPQ me sistemet tjera.
- iii. Integrimi i raportimit nga njësi të ndryshme të ZKM-së në një raport të unifikuar për Kryeministrin/Qeverinë.

## 8.1 Veprimet

### Gjatë vitit 2015

1. Sistemi i Monitorimit dhe Raportimit të PVPQ-së (SKQ) të konfirmohet si sistemi primar i monitorimit të performancës për tu shfrytëzuar nga institucionet qendrore dhe ministrinë në zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar.
2. Një metodologji dhe strukturë zyrtare të zhvillohet (bashkërisht nga SKQ, ZPS, MIE) për të siguruar konsistencën dhe metodologjinë e unifikuar për të gjitha kornizat e planifikimit dhe monitorimit dhe të përdoret nga SKQ/PVPQ dhe të gjitha ministrinë e linjës.
3. Një Plan Vjetor i Monitorimi (për vitin 2016) të përgatitet nga secila ministri e linjës dhe të negociohet me ZKM, MIE, MF. Plani duhet të identifikoj se cilat prioritet të larta dhe caqe të produkteve do të monitorohen nga institucionet qendrore dhe cilat duhet ti nënshtrohen monitorimit të brendshëm të ministrive. SKQ duhet të zhvilloj procedurat dhe udhëzimet e nevojshme.
4. SKQ të fuqizohet për të mbështetur Sistemin e Monitorimit dhe Raportimit në baza të rregullta si funksion qendror i departamentit.
5. Të qartësohen modalitetet, roli dhe përgjegjësitë për monitorimin e Udhërrëfyesit për Zbatimin e SKZH-së dhe monitorimit ekzistues, që në parim duhet të bëhet në kuadër të PVPQ-së. ZPS dhe SKQ duhet të zhvillojnë një propozim të përbashkët për adresimin e kësaj çështje.

### Gjatë vitit 2016

6. Të prodhohet raporti vjetor i ministrive (së paku deri në mesin e shkurtit) duke identifikuar rezultatet e arritura përballë zotimeve dhe buxhetit të miratuar të përcaktuara në Raportin Vjetor të Integruar të Ministrisë për vitin përkatës. Si i tillë duhet të informoj fillimin e procesit të përgatitjes së KASH-it. KPS (dhe nëse kërkohet edhe Kabineti) të informohen rreth rezultateve të monitorimit për vitin 2015. Ky aktivitet duhet të përsëritet çdo vit.
7. Zhvillimi i ndërveprimit ndërmjet Sistemit për Monitorimin dhe Raportimin e PVPQ-së me sisteme të tjera (MIE, MF), duke mundësuar shkëmbim të informatave/të dhënave për shfrytëzues të ndryshëm

8. Sistemi i Monitorimit dhe Raportimit të PVPQ-së të harmonizohet me sistemin e klasifikimit të SKZH-së/KASH-it/Buxhetit vjetor me zbatimin e sistemit të ri dizajnuar për tu realizuar në vitin 2017.
9. Sistemi i Monitorimit dhe Raportimit të PVPQ-së mbulon të gjitha produktet e miratuara të ministrive dhe caqet e produkteve dhe se ato të marrin kod të veçantë për të mundësuar monitorim të specializuar (për shembull – çështje nga Programi i Qeverisë apo Plani i Zbatimit të MSA-së).
10. Ministritë përgatisin Planin Vjetor të Monitorimit për vitin 2017.

## Aneksi – Kalendar i Zbatimit të SPI-së

### ASPEKTET KRYESORE TË ZBATIMIT TË SPI-SË 2015-2017

Periudha	Veprimi
<p><b>2015:</b></p> <p><b>Maj - qershor</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qeveria nxjerr vendimin për themelimin e Komisionit për Planifikim Strategjik (KPS)</li> <li>• KPS miraton kalendarin e planifikimit të integruar (pjesa e mbetur e vitit 2015)</li> <li>• Qeveria nxjerr vendimin për fillimin e hartimit të SKZH-së</li> <li>• Rishikimi i kalendarit të KASH-it/buxhetit vjetor, duke përcaktuar aspektet kryesore të vendimmarrjes ku përfshihen vendimet e KPS-së/KM-së</li> </ul>
<p><b>2015:</b></p> <p><b>Korrik – shtator</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• SKZH finalizohet dhe miratohet nga KPS/Qeveria</li> <li>• KPS miraton kriteret për konsolidimin e strategjive sektoriale. Numri i strategjive sektoriale të kufizohet në rreth 20-25.</li> <li>• ZPS zhvillon udhëzimet për përgatitjen e strategjive sektoriale të konsoliduara. Udhëzimet e rishikuara për përgatitjen e strategjive sektoriale të përfshihen në Rregulloren e Punës ose udhëzimin administrativ përkatës.</li> </ul>
<p><b>2015:</b></p> <p><b>Tetor dhjetor</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryeministri nxjerr një vendim për krijimin e Grupit për Menaxhim Strategjik (GMS) për tu kryesuar nga ministri përkatës në secilën ministri të linjës</li> <li>• Udhërrëfyesi për zbatimin e SKZH-së është përgatitur dhe miratuar nga SKZH</li> <li>• ZPS/SKQ zhvillojnë modalitetet e monitorimit për SKZH dhe sigurojnë shpërndarjen e tyre dhe udhëzimin e ministrive të linjës. ZPS/SKQ prodhojnë një kornizë të detajizuar të proceseve të zbatimit të Udhërrëfyesit të SKZH-së dhe institucioneve kyçe me përcaktimin e rolit dhe përgjegjësisë e të gjitha institucioneve që do të jenë pjesë e zbatimit dhe monitorimit të SKZH-së.</li> <li>• ZPS, MF, dhe MIE bashkërisht vlerësojnë nevojën për rishikimin e strategjive sektoriale ose përgatitjen e strategjive të reja gjatë periudhës 2016-2017. ZPS përgatit një plan për rishikimin e strategjive sektoriale ose përgatitjen e strategjive të reja për periudhën 2016-2017.</li> <li>• MIE përgatit Planin Kombëtar për Adoptimin e Acquis (PKAA).</li> <li>• MF/ZPS përgatisin instruksionet e reja për përgatitjen e KASH-it/Buxhetit vjetor bazuar në “strukturën e programeve”, për tu pilotuar në vitin 2016.</li> <li>• Sistemi Informativ për Monitorimin e PVPQ-së përmes vendimit të KM/KPS konfirmohet si sistemi parësor i monitorimit të performancës për tu shfrytëzuar nga institucionet qendrore, po ashtu edhe për SKZH.</li> <li>• Një plan vjetor/plan monitorimi për vitin 2016 (si pjesë e kontributit për PVPQ) të përgatitet nga secila ministri e linjës dhe negociohet me ZKM, MF dhe MIE. SKQ duhet të zhvilloj procedurat dhe udhëzimet përkatëse.</li> </ul>

<p><b>2016: Janar – qershor</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• KPS miraton Kalendarin e Planifikimit të Integruar për vitin 2016.</li> <li>• Raportet vjetore të monitorimit të ministrive (për vitin 2015) përgatiten nga SKQ dhe i prezantohen KM/KPS.</li> <li>• Një strukturë e buxhetimit sipas programeve fillon të pilotohet në dy ose tri ministri të linjës. MF përgatit udhëzimet dhe procedurat përkatëse.</li> <li>• Ministrinë e linjës fillojnë pilotimin/përgatitjen e strategjive sektoriale (sa më shumë që është e mundur gjatë vitit 2016).</li> <li>• ZKM drejton përgatitjen e një numri të kufizuar të strategjive ndër-sektoriale (krahas strategjive sektoriale) për të adresuar zotimet e politikave që nuk janë nën mandatin e asnjë ministrie.</li> <li>• Përfshirje të plotë të prioriteteve të SKZH dhe PKAA në KASH 2017-2019.</li> <li>• Përmirësimi i kostimit të produkteve të SKZH, Planit për Zbatimin e MSA-së për tre vitet e para të KASH-it.</li> <li>• Vala e parë e rishikimit të strategjive sektoriale të informoj përgatitjen e përcaktimit të kufijve të KASH-it.</li> <li>• KASH 2017-2019 miratohet nga KPS/Qeveria.</li> <li>• MF rishikon procedurat e shqyrtimit të Programit për Investime Publike, duke mundësuar “proces shqyrtimi të përbërë nga tri faza” (MF-GDPS-KPS) para përfundimit të KASH-it/Buxhetit vjetor dhe vendimeve të qeverisë.</li> <li>• MF përcakton procedurat për përgatitjen e “Listës së Projekteve për Investimet Publike” për tu financuar</li> <li>• SKQ fillon zhvillimin e ndërveprimit ndërmjet Sistemit Informativ të Monitorimit dhe Raportimit të PVPQ-së me sisteme të tjera (MIE, MF), duke mundësuar shkëmbimin e informatave/të dhënave për shfrytëzues të ndryshëm.</li> <li>• KPS miraton metodologjitë, standardet dhe formatet për të udhëzuar procesin e përgatitjes dhe dorëzimit të projekteve për tu financuar përmes ndihmës së jashtme/partnerëve zhvillimor (faza e identifikimit, fizibilitetit dhe vlerësimit)</li> <li>• Rishikimi i procedurave për shqyrtimin e projekteve të ndihmës së jashtme, duke mundësuar “proces shqyrtimi të përbërë nga tri faza” (MIE(+)/GDPS/KPS). Zhvillimi i procedurave për GDPS – “faza e dytë e shqyrtimit/filtrimi i projekteve”. Zhvillimi i procedurave për KPS “faza e tretë e shqyrtimit”</li> </ul>
<p><b>2016: Qershor – dhjetor</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një dokument Vjetor me Listën e Projekteve për tu financuar përmes fondeve të jashtme/partnerëve zhvillimor të përgatitet në fund të procesit të KASH-it</li> <li>• Buxheti vjetor 2017 i miratuar</li> <li>• Sistemi i Monitorimit dhe Raportimit të PVPQ-së të harmonizohet me sistemin e klasifikimit të SKZH-së/KASH-it/Buxhetit vjetor me zbatimin e sistemit të ri dizajnuar për tu realizuar në vitin 2017.</li> <li>• Sistemi i Monitorimit dhe Raportimit të PVPQ-së mbulon të gjitha produktet e miratuara të ministrive dhe caqet e produkteve dhe se ato të</li> </ul>

	<p>marrin kod të veçantë për të mundësuar monitorim të specializuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• KPS miraton valën e dytë të strategjive sektoriale (SKZH) për tu përgatitur në vitin 2016.</li> <li>• Ministritë përgatisin Planin Vjetor të Monitorimit të Punës 2017</li> </ul>
<b>2017</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• KPS miraton Kalendarin e Planifikimit të Integruar për vitin 2017 dhe raportin vjetor të planeve të monitorimit të ministrive (rezultatet për 2016)</li> <li>• Vala e tretë e strategjive të rishikuara sektoriale e përfunduara dhe shfrytëzohet për të informuar prioritetet e KASH-it dhe përgatitjen e kufijve</li> <li>• Struktura e buxhetit sipas programeve shtrihet në të gjitha ose (vala e dytë) një numër të caktuar të ministrive të linjës<sup>9</sup></li> <li>• KPS për të zbërthyer kufijtë e KASH-it/buxhetit vjetor nga niveli i sektorit edhe në nivel të programeve. Prezantimi i kufijve të shpenzimeve rrydhëse dhe kapitale edhe në nivel të programeve për të gjitha ministritë.</li> <li>• Ofrimi i trajnimeve gjithëpërfshirëse për MF/Departamentin e Buxhetit dhe Ministritë e linjës lidhur me “strukturën e buxhetit sipas programeve” dhe procedurat përcjellëse</li> <li>• Përfshirja e prioriteteve të rishikuara të SKZH dhe PKAA në KASH 2018-2020</li> <li>• Përmirësimi i kostimit të produkteve të rishikuara të SKZH, Planit për Zbatimin e MSA-së për tre vitet e para të KASH-it.</li> <li>• Ministritë përgatisin Planin Vjetor të Monitorimit të Punës 2018</li> <li>• Raporti vjetor i progresit të SKZH-së (rezultatet për 2016)</li> </ul>
<b>2018</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rishikimi afatmesëm dhe dokumenti i freskuar i SKZH-së i përfunduar</li> <li>• Zbatimi i të gjitha proceseve të SPI-së të iniciuara gjatë tri viteve të kaluara.</li> </ul>

<sup>9</sup> Një vendim për këtë duhet të merret bazuar në vlerësimin e gjendjes dhe përvojën nga vala e parë e ministrive të pilotuara në vitin 2016